

Shtyhet thirrja për aplikime për bursa për studentët e Universitetit të Tiranës në Universitetin e Shkencave të Aplikuara Koblenz, në Gjermani, për semestrin e dytë të vitit akademik 2021 - 2022.

Në kuadër të programit Erasmus+ është shtyrë thirrja për aplikime për bursa për mobilitete për studentët e Universitetit të Tiranës në Universitetin e Shkencave të Aplikuara Koblenz, për semestrin e dytë të vitit akademik 2021 - 2022.

<https://www.hs-koblenz.de/rac/index>

Llojet e mobilitetit përfshijnë:

- Shkëmbimin e studentëve për studime, internship;

Kohëzgjatja e bursave:

- Bachelor (1 semestër);
- Master (1 semestër).

Studentët e vitit të tretë Bachelor dhe studentët e vitit të dytë Master nuk mund të aplikojnë.

Fushat e studimit:

- Informatikë Ekonomike;

Për më shumë informacion mbi lëndët në gjuhën angleze klikoni në adresën:

https://www.hs-koblenz.de/fileadmin/media/user_upload/t3_mitarbeiter/Courses_taught_in_English_-_Winter_Semester_2020-2021.pdf

Për informacion mbi Internshipin e ofruar për studentët klikoni në adresën:

<https://www.hs-koblenz.de/rac/international-programs/international-students/exchange-students/academic-internship>

Studentët që aplikojnë për Internship duhet që krahas internshipit (15 ECTS) të kryejnë edhe lëndë akademike për të përmbushur 30 ECTS.

Bursat përfshijnë:

- Kompensimin mujor (800 EUR në muaj për studentët);
- Kostot e udhëtimit (në varësi të distancës midis universitetit pritës dhe atij të origjinës)

DISTANCA E UDHËTIMIT (http://ec.europa.eu/programmes/erasmus-plus/tools/distance_en.htm)	Kompensimi
Midis 100 dhe 499 KM	180 EUR
Midis 500 dhe 1999 KM	275 EUR
Midis 2000 dhe 2999 KM	360 EUR
Midis 3000 dhe 3999 KM	530 EUR
Midis 4000 dhe 7999 KM	820 EUR
8000 KM ose më shumë	1100 EUR

Për të përcaktuar distancën ju lutem referohuni:

http://ec.europa.eu/programmes/erasmus-plus/tools/distance_en.htm

Studentët që përfitojnë nga mobiliteti Erasmus+ nuk do të paguajnë asnjë tarifë për shkollim në universitetin pritës. Studentët do të vazhdojnë të paguajë shkollimin e tyre dhe/ose tarifat e regjistrimit në universitetin e tyre të origjinës.

Dokumentat e nevojshme për aplikim për nivelin Bachelor:

- CV;
- Kopje e Pasaportës;
- Vërtetim studenti (të përkthyer në mënyrë zyrtare në gjuhën angleze/gjermane);
- Listë notash (të përkthyer në mënyrë zyrtare në gjuhën angleze/ gjermane);
- Letër motivimi (gjuhën angleze/ gjermane në varësi të gjuhës në të cilën zhvillohet programi i studimit);
- Certifikata e gjuhës së huaj (gjuhë angleze ose gjermane në varësi të gjuhës në të cilën zhvillohet programi i studimit)
- Dokumenti Learning Agreement* (studentët duhet të plotësojnë minimalisht 30 ECTS dhe në UT duhet të njihen minimalisht 20 ECTS)

**Learning Agreement është një kontratë midis universitetit të origjinës dhe aplikantit dhe shërben për të përcaktuar lëndët që do të zhvillohen në universitetin pritës. Ju duhet të plotësoni vetëm seksionin e parë “Before the Mobility. Në tabelën A përcaktohen lëndët dhe kreditet që do të merrni në universitetin pritës, në tabelën B përcaktohet se cilat prej lëndëve të Tabelës A do të njihet në Universitetin e Tiranës kur ju të keni përfunduar periudhën e shkëmbimit.*

KUJDES: Ju duhet të përzgjidhni të kryeni në Universitetin e Shkencave të Aplikuara Koblenz lëndë të njëjta me ato që do të kryeni në semestrin e parë në fakultetin tuaj, kjo në mënyrë që lëndët dhe kreditet t’ju njihen kur të ktheheni. Nëse lëndët e përzgjedhura ndryshojnë nga ato që do të zhvillohen në fakultetin tuaj semestrin e parë, atëherë kur të ktheheni duhet të zhvillohen lëndët që nuk përshtaten në Universitetin e Tiranës.

Dokumenti ‘‘Learning Agreement’’ tek seksioni ‘‘Commitment’’ firmoset nga aplikanti, më pas nga koordinatori akademik në nivel fakulteti dhe në fund në Rektorat nga Koordinatori Institucional i Erasmus +.

Nëse studenti kryen ndryshime ‘‘During mobility’’, kjo pjesë e dokumentit duhet firmosur nga aplikanti, më pas nga koordinatori akademik në nivel fakulteti dhe në fund në Rektorat nga Koordinatori Institucional i Erasmus +.

Për të shkarkuar formatin e Learning Agreement klikoni në adresën:

https://unitir.edu.al/wp-content/uploads/2020/09/Learning_agreement_for_studies_Erasmus_outgoing-2-1.docx

Dokumentat e nevojshme për aplikim për studentët e nivelit Master:

-CV (në gjuhën angleze/ gjermane);

-Kopje e Pasaportës;

-Vërtetim studenti (në gjuhën shqipe dhe e përkthyer në mënyrë zyrtare në gjuhën angleze/ gjermane në varësi të programit të studimit);

-Diplomë e nivelit Bachelor;

-Listë notash e nivelit Bachelor (në gjuhën shqipe dhe e përkthyer në mënyrë zyrtare në gjuhën angleze/ gjermane në varësi të programit të studimit);

-Listë notash e nivelit Master (në gjuhën shqipe dhe e përkthyer në mënyrë zyrtare në gjuhën angleze/ gjermane në varësi të programit të studimit);

-Letër Motivimi në gjuhën angleze/ gjermane në varësi të programit të studimit;

-Certifikatë e gjuhës së huaj (Anglisht/ Gjermanisht në varësi të programit të studimit);

-Learning Agreement* (studentët duhet të plotësojnë minimalisht 30 ECTS dhe në UT duhet të njihen minimalisht 20 ECTS);

**Learning Agreement është një kontratë midis universitetit të origjinës dhe aplikantit dhe shërben për të përcaktuar lëndët që do të zhvillohen në universitetin pritës. Ju duhet të plotësoni vetëm seksionin e parë ‘‘Before mobility. Në tabelën A përcaktohen lëndët dhe kreditet që do të merrni në universitetin pritës, në tabelën B përcaktohet se cilat prej lëndëve të Tabelës A do të njihet në Universitetin e Tiranës kur ju të keni përfunduar periudhën e shkëmbimit.*

KUJDES: Ju duhet të përzgjidhni të kryeni në Universitetin e Shkencave të Aplikuara Koblenz lëndë të njëjta me ato që do të kryeni në semestrin e parë në fakultetin tuaj, kjo në mënyrë që lëndët dhe kreditet t’ju njihen kur të ktheheni. Nëse lëndët e përzgjedhura ndryshojnë nga ato

që do të zhvillohet në fakultetin tuaj semestrin e parë, atëherë kur të ktheheni duhet të zhvilloni lëndët që nuk përshtaten në Universitetin e Tiranës.

Dokumenti “Learning Agreement” tek seksioni “Commitment” firmoset nga aplikanti, më pas nga koordinatori akademik në nivel fakulteti dhe në fund në Rektorat nga Koordinatori Institucional i Erasmus +.

Nëse studenti kryen ndryshime “During mobility”, kjo pjesë e dokumentit duhet firmosur nga aplikanti, më pas nga koordinatori akademik në nivel fakulteti dhe në fund në Rektorat nga Koordinatori Institucional i Erasmus +.

Për të shkarkuar formatin e Learning Agreement klikoni në adresën:

https://unitir.edu.al/wp-content/uploads/2020/09/Learning_agreement_for_studies_Erasmus_outgoing-2-1.docx

Afati për aplikim: **21 Janar 2022**

Dokumentat duhen dorëzuar dorazi në Rektoratin e Universitetit të Tiranës, Sektori i Marrëdhënieve me Jashtë, si dhe duhet të dërgohen të skanuara në e-mailin iro@unitir.edu.al.

Për më shumë informacion mbi bursat mund të na kontaktoni në adresën: iro@unitir.edu.al.

Universiteti i Tiranës ju uron suksese në aplikimin tuaj!